

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i pergjithshem- dega në Novobërdë, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me bashkpunëtorin profesional Sylejman Regjepi, në qështjen penale kundër të akuzuarit M. T. nga fsh. ..., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit në bashkëveprim nga neni 285 parag. 2 lidhur me neni 23 të KPK-së, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me 23.05.2016 në prezencën e Prokurorës të Shtetit Rozelida Hasani, të akuzuarit M. T., mori këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. T., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati ZH. , dhe e ëma S.,e lindur T., i lindur , në ..., me vendbanim në fsh,... , Komuna e ..., serb, Shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, din shkrim dhe lexim, i papunësuar, i gjendjes së varfër, kinse deri më tani i pa denuar,dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij.

Në mbështetje të nenit 363 parag. 1 nën parag. 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,

Refuzohet akuza

Sepse me date 18.11.2012, rreth ores 15.00h, ne territorin e fshatit..., Komuna e Novobërdës, te vendi i quajtur ..., te pandehurit me qellim vjedhje dhe shitje, ne pyllin e pronesise private dhe shteterore, me sharre motorike kane prere gjithsej 98 trungje dru bungu, me diameter prej 10-22 cm, me lartesi 5-9m, si dhe me vellim te pergjithshem prej 8.11m kub, duke e demtuar Ekonomine e Pyjeve ne vlere prej 730.00 euro.

-me qka kishte për të kryer veprën penale ne bashkekryerje Vjedhje Pylli, nga neni 285 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Shpenzimet e procedures penale bien në ngarkesë të mjeteve bugjetor të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale nga Gjilani, me aktakuzën PP.nr.2629/2012 prej dates 12.12.2012, e ka akuzuar M.Gj. -per shkak te vepres penale ne bashkekryerje Vjedhje Pylli, nga neni 285 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Në fillim të séances për shqyrtim gjyqesor pas marjes ne pyetje te deshmitarit S.... Gj..., i cili deklaroi se tani te akuzuarin M.T. nuk e ka takuar ne pyllin shoqeror duke prere dru dhe se shenimet per te njejtin mi kane dhene gabimisht andaj prokurorja e shtetit Rozelida Hasani ka hequr dorë nga ndjekja penale kundër të akuzuarit M....T....

Pasi që prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, ka hequr dorë nga ndjekja penale gjykata duke u mbështetur në këtë dhe në nenin 363 parag. 1 nën parag. 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, e ka refuzuar akuzën.

Për shpenzimet e procedures penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
-DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
-Dega ne Novoberde,
Më datën 23.05.2016.**

*Bashkepuntori Profesional
Sylejman Rexhepi*

*Gj y q t a r i,
Hasan Sadiku*

Këshilla Juridike: *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.*

